# DËSHMI ARKIVI

**A-446399**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Gruda: Shpresojmë që nesër katër ish-drejtuesit e UÇK-së të lirohen, të vërtetën e luftës do ta mbrojmë |
| ADRESA | `https://albeu.com/kosove/gruda-shpresojme-qe-neser-kater-ish-drejtuesit-e-uck-se-te-lirohen-te-verteten-e-luftes-do-ta-mbrojme/1012832/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 14:40:34 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 14:35:57 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `c752d54d18c6c4a170fd549547e79f162822bcff36c4139da92d9deeb92572e0` |
| TEKSTI | `56b72d470dc6a70b35f93327dbe6f97a1aab6b891ae7ad2b7cdcbc63cb7ada4e` |
| PAMJA | `d4c6e39da1e0d03751a8b9fd586374eb82b8bb584e3173bd1616f381575c1a51` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `a24062edefa951bacb643fbb27f87b0de23a4ddad67a206cee4a7a36ede8fc50` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `20a2ff67bec0970ebd6ac7b02e4b09aabe3ec6a4bb974bdfd1be2c012f68e490` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/a24062edefa951bacb643fbb27f87b0de23a4ddad67a206cee4a7a36ede8fc50`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Gruda: Shpresojmë që nesër katër ish-drejtuesit e UÇK-së të lirohen, të vërtetën e luftës do ta mbrojmë



Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Përparim Gruda, deklaroi se PDK-ja pret që nesër Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi të shpallen të pafajshëm dhe të lirohen nga të gjitha aktakuzat.

Sipas Grudës, lufta çlirimtare dhe mbrojtëse e Kosovës nuk mund të barazohet me politikën shtetërore të agresionit, represionit dhe spastrimit etnik të regjimit serb.

Gjatë një konference për media, 18 orë para shpalljes së verdiktit përfundimtar nga Gjykata Speciale në Hagë, ai tha se Kosova pret një vendim të drejtë.

“Me shpresë dhe besim, sot themi se nesër duam të festojmë. Shpresojmë t’i shohim Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin të lirë, në rrugën e kthimit drejt Kosovës. Deri në atë moment, detyra jonë është e qartë: do të mbrojmë të vërtetën e luftës së UÇK-së, sakrificën e popullit të Kosovës dhe legjitimitetin e shtetit tonë”, u shpreh Gruda.

Ai paralajmëroi se çdo vendim tjetër do të kundërshtohet fuqishëm, përmes argumenteve dhe të gjitha mjeteve juridike e demokratike që janë në dispozicion.

“Edhe partnerëve tanë ndërkombëtarë u kërkojmë atë që e kemi kërkuar vazhdimisht: drejtësi të mbështetur në prova, standarde të njëjta për të gjithë dhe respekt për të vërtetën historike të Kosovës”, deklaroi deputeti i PDK-së.

Gruda rikujtoi represionin, dhunën, dëbimet, vrasjet dhe krimet e kryera për dekada ndaj popullit të Kosovës, duke theksuar se historia nuk mund të ndryshohet.

të fundit/


Gruda: Shpresojmë që nesër katër ish-drejtuesit e UÇK-së t…


Investim në arsim i ABI Bank, gjithëpërfshirje dhe mundësi të…


Barcelona synon të transferojë te Manchester Unitedi…


Rodri rrëfen cilin futbollist do të afronte te Barcelona


Arsovski: Anëtarësimi në BE nuk mund të kthehet në një pritje t…


Kuvendi shtyn për një moment tjetër zgjedhjen e anëtarit t…


Spartak Ngjela: SPAK nuk vepron pa prova, mbështetja…

ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

"Në vitin 1999, UÇK-ja dhe demokracitë perëndimore qëndruan në të njëjtën anë të historisë. Ky bashkëpunim dhe përkrahja ndërkombëtare i dhanë fund një katastrofe humanitare dhe krijuan rrugën drejt lirisë dhe shtetit të Kosovës. Për këtë arsye, historia e Kosovës nuk duhet të rishkruhet. Është e qartë kush ishte agresori dhe kush viktima, kush përdori dhunën e represionin, kush dëboi qindra mijëra qytetarë nga shtëpitë e tyre dhe përse ndërhyri bota demokratike", theksoi ai.

Deputeti i PDK-së u bëri thirrje të gjithë akterëve publikë të ruajnë qetësinë dhe të shmangin krijimin e panikut të panevojshëm te qytetarët.

"Në PDK i kemi ndjekur me shqetësim disa reagime publike të ditëve të fundit, të cilat kanë shkaktuar ankth të panevojshëm te qytetarët. Në rrethana të tilla, çdo akter publik duhet të tregojë maturi dhe kujdes. Kosova e ka dëshmuar se momentet e mëdha di t'i përballojë me dinjitet", tha Gruda.

Shtuar më 15.09.2026 16:35

Tags: Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës , Katërshja , lirim , uck


Prokurorja Laura Pula përfundon karrierën dhe del në pension


Dy muaj shtesë paraburgimi për Veselin dhe Krasniqin një ditë par…


Fetoshi: Vendimi i Hagës, një pikë kthese historike për Kosovën


Thirrjet për dhunë para vendimit të Hagës – a rrezikojnë ato pozitën e t…



Eksperti Shala: 16 shtatori kërkon vigjilencë, por nuk nënkupton…


Ndërpriten negociatat për presidentin mes LVV-së dhe LDK-së


BIK-u urdhëron ekspozimin e flamurit të UÇK-së në institucionet dhe xhamitë …


Sa ndikojnë protestat dhe kërcënimet në vendimin e gjykatës për ish-…

albeu © 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko… Kërko

**Kryesore**
Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

**Kategori**
Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

**Linqet**
Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

**Tags**
Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

**Moti**
Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.